



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER PERIAN B. BODINAKU
ADRESA Ç. TOPULLI
TEL: 674010104


VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 13626

Tirane më 18/07/2023


Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2023052640865954878

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER PERIAN B. BODINAKU**



V2023052640865954878

VËRTETIM NËN SHKRIMI

Sot, më datë 18.07.2023, para meje Notere PERIAN B. BODINAKU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Ç. TOPULLI, u paraqit personalisht:

DEKLARUESIT: Nikolin Risilia, atësia Dhimitraq, amësia Afërdita, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, me adresë P.N. Luarasi; Nd. 4; Njësia Administrative Nr. 1; Njesia Bashkiake Nr. 1; 1004; Tiranë, lindur më 19/02/1975, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036229505 dhe nr. personal H50219159T, .

Fatjona Sako, atësia Sabri, amësia Kismete, shtetase Shqiptare, lindur në Burrel, Mat dhe banues në Tiranë, me adresë Sadik Petrela; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 3; Njesia Bashkiake Nr. 3; 0000; Tiranë, lindur më 01/01/1993, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035757092 dhe nr. personal J35101080R, .

Artur Dado, atësia Thoma, amësia Marianthi, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në TIRANË, me adresë Xhavit Shyqyri Demneri; Nd. 8; H. 1; Ap. 2; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1010; Tiranë, lindur më 25/06/1977, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033663506 dhe nr. personal H70625158J, .

Redman Toska, atësia Andrea, amësia Dhurata, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Siri Kodra Nr.30; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 0000; Tiranë, lindur më 23/09/1973, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038654774 dhe nr. personal H30923135P, .

Artan Dersha, atësia Hiqmet, amësia Metije, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Lord Bajron Nj 11; Nd. 183; H. 1; Ap. 183; Njësia Administrative Nr. 11; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 07/06/1963, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034036606 dhe nr. personal G30607119J, .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "STATUTI I SHOQATES , Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve të Mbrojtjes nga Zjarri , (SIMZ) ", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.



V2023052640865954878

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

PERIAN B. BODINAKU

STATUTI I SHOQATËS

“Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve të Mbrojtjes nga Zjarri, (SIMZ)”

Në mbështetje të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo fitimprurëse” i ndryshuar (OJF) me Aktin e Themelimit nr. rep. 1071, nr. kol. 362, datë 28.12.2022 është krijuar organizata jofitimprurëse “Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve të Mbrojtjes nga Zjarri (SIMZ)”.

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Forma e organizimit

Shoqata e Inxhinierëve të Mbrojtjes nga Zjarri (SIMZ) është një organizatë jofitimprurëse me anëtarësi e themeluar me vullnetin e lirë të anëtarëve të saj si Inxhinierëve, Profesorëve, Studiuesve etj., që organizohet në formën e shoqatës.

Neni 2

Emri, sigla dhe simboli i veçantë


1. Shoqata vepron nën emrin “Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve të Mbrojtjes nga Zjarri” dhe emërtohet shkurt “SIMZ”.
2. Shoqata ka selinë e saj në adresën “Rruga e Kavajes”, Kompleksi “Parku Lana”, Kati i 2-të, Tiranë.
3. Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve të saj ka të drejtën të vendos për ndryshimin e adresës.
4. Shoqata mund të kryej veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë duke hapur degë apo filiale të saj.
5. Shoqata ka vulën e saj me mbishkrimin në gjuhën shqipe: “Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve të Mbrojtjes nga Zjarri (SIMZ) dhe me siglën e cila është një trekëndësh i kuq me simbolin e flakës në mes.

Neni 3

Themeluesit

Themeluesit e janë:

- 1) **Z.Nikolin Risilia**, i biri i Dhimitraqit, shtetas shqiptar lindur në Fier, me datë 19.02.1975, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me letërnjoftim nr. 036229505 dhe nr.personal H50219159T;
- 2) **Znj.Fatjona Sako** e bija e Sabriut, shtetase shqiptare, lindur më 01.01.1993, në Burrel dhe banuese në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e Letërnjoftimit ID me nr.035757092 dhe nr. personal J35101080R;



- 3) **Z. Artur Dado**, i biri i Thomait, shtetas shqiptar, lindur më 25.06.1977, në Tiranë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. 033663506 dhe nr. personal H70625158J;
- 4) **Z. Redman Toska**, i biri i Andreas shtetas shqiptar, lindur më 23.09.1973, në Fier dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. 032285987 dhe nr. personal H30923135P.
- 5) **Z. Artan Dersha**, i biri i Hiqmetit, shtetas shqiptar, lindur më 07.06.1963, në Tiranë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. 034036606 dhe nr. personal G30607119J.

Neni 4 Kohëzgjatja

“Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve të Mbrojtjes nga Zjarri” themelohet dhe ushtron veprimtarinë e saj pa afat. Kohëzgjatja e saj mund të kufizohet nga një Vendim i motivuar i Mbledhjes së përgjithshme të anëtarësisë. Përfundimi i veprimtarisë së shoqatës bëhet me vendim të Mbledhjes së Përgjithshme ose me Vendim të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas rasteve të parashikuara në nenin 44 të ligjit “Për organizatat jofitimprurëse.

KREU II

QËLLIMI DHE FUSHA E VEPRIMTARISË



Neni 5 Qëllimi

Qëllimi i “Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve të Mbrojtjes nga Zjarri” është të përcaktojë, të zhvillojë dhe të avancojë përdorimin e praktikave më të mira inxhinierike për mbrojtjen nga zjarri, të zgjerojë njohuritë bazë shkencore dhe teknologjike si dhe të edukojë komunitetin për rreziqet nga zjarri, me qëllim reduktimin e risqeve që vijnë nga zjarri.

Neni 6 Veprimtaria e shoqatës

Për arritjen e qëllimeve të saj shoqata, zhvillon një sërë veprimtarish të cilat bazohen në:

- Avancimi i inxhinierisë të mbrojtjes nga zjarri, përmes avancimit të artit dhe shkencës së inxhinierisë së mbrojtjes nga zjarri dhe fushave aleate të saj, duke avancuar dhe mbështetur edukimin inxhinierik të mbrojtjes nga zjarri, duke shpërndarë informacion dhe duke mbajtur një nivel të lartë qëndrimi dhe kompetence midis anëtarëve të tij;
- Promovimi i profesionit të inxhinierit të mbrojtjes nga zjarri, përmes avancimit të artit dhe shkencës së inxhinierisë së mbrojtjes nga zjarri dhe fushave aleate të tij; duke mbajtur një pozitë të lartë profesionale midis anëtarëve të saj; dhe duke promovuar dhe mbështetur edukimin inxhinierik për mbrojtjen nga zjarri;
- Zhvillimi, avancimi dhe përdorimi i praktikave më të mira inxhinierike; zgjerim i bazës së njohurive shkencore dhe teknike; dhe edukimi i komunitetit global të sigurisë nga zjarri, në mënyrë që të reduktohet rreziku nga zjarri.

M. Piskup    2

Neni 7
Burimet dhe përdorimi i të ardhurave

1. Të ardhurat për financimin e veprimtarive të shoqatës për arritjen e qëllimit dhe objektivave do të sigurohen nga:

- a) Fonde të siguruara nga themeluesit;
- b) Grante të ndryshme;
- c) Dhuratat apo donacionet e ofruara nga subjekte privatë ose publike, vendas ose të huaj;
- d) Në çdo formë tjetër të ardhure të ligjshme.

2. Shoqata siguron të ardhura nga burime që njihen nga ligji dhe bën shpenzime vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë, për të cilin është krijuar, si dhe për drejtimin e mirëmbajtjen e pasurisë së saj.
3. Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e shoqatës prej personave që janë subjekte të statutit ose aktit themelues, përveç detyrimeve në formën e pagave, rrogave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të shoqatës.
4. Shoqata, në raste të veçanta, mund të japë ndihmë financiare anëtarëve të saj, personave të jashtëm ose subjekteve të tjera. Shoqata mund të japë ndihma të tilla edhe nga fonde të dhuruara ose të vëna në dispozicion, kur donatorët kanë përcaktuar shprehimisht një të drejtë të tillë.

KREU III

ORGANET DREJTUESE DHE KOMPETECAT E TYRE

Neni 8
Organet e shoqatës

1. Organet drejtuese dhe ekzekutive të shoqatës janë:
 - a) Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë;
 - b) Drejtori Ekzekutiv.
2. Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese përcaktohen në këtë statut.

Neni 9
Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë

1. Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë është organi më i lartë drejtues i shoqatës dhe përbëhet nga anëtarët e miratuar të shoqatës të cilët përfaqësohen me një votë secili. Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë mund të marrë vendime të vlefshme vetëm kur

3

Wollisnyg [Signature] [Signature] [Signature] [Signature]

thirret në mënyrë të rregullt në përputhje me statutin dhe në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të shoqatës. Mund të marrin pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarësisë dhe të tjerë pa të drejtë vote të ftuar apo persona të tretë kur Mbledhja e Përgjithshme të Anëtarësisë e miraton prezencën e tyre.

2. Mbledhja e Përgjithshme të Anëtarësisë do të mbledhet sa herë është e nevojshme për interesat e shoqatës, në përputhje me procedurat në statut, por në çdo rast jo më pak se një herë në vit në mbledhjen e përvitshme si rregull në Dhjetor të vitit aktual, por jo më vonë se muaji qershor të vitit pasardhës.

Neni 10

Votimi i Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë

1. Në mbledhjen e përgjithshme vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm.
2. Të gjitha veprimet e rëndësishme e shoqatës si: vendimet që kanë lidhje me ndryshimin e këtij statuti, ristrukturimin, prishjen apo likuidimin e shoqatës, zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të saj miratohen me një shumicë prej $\frac{3}{4}$ të anëtarësisë.
3. Si rregull votohet në mënyrë të hapur. Nëse një nga anëtarët i pranishëm kërkon votim të fshehtë, drejtuesi i seancës do ta hedhë kërkesën për votim.

Neni 11

Kompetencat e Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë

Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë të shoqatës ka këto kompetenca:

- a) Likuidimin, shpërndarjen, bashkimin ose transformimin e shoqatës në një organizatë të një forme tjetër,
- b) Ndryshimin e këtij statuti dhe të akteve që rregullojnë veprimtarinë e shoqatës.
- c) Përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë së shoqatës, mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre.
- d) Zgjedh, emëron dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv si dhe përcakton detyrat e tij.
- e) Miraton raportin vjetor.
- f) Miraton buxhetin e shoqatës për vitin e ardhshëm dhe pasqyrat financiare.
- g) Përcakton politikën dhe programin e shoqatës në përputhje me qëllimin e saj.
- h) Merr vendime të tjera që lidhen me arritjen e objektivave të shoqatës.
- i) Miraton kufirin minimal dhe maksimal të kuotës vjetore të anëtarësisë si dhe vendos lidhur me anëtarësimet e reja në shoqatë.
- j) Miraton kalendarin e aktiviteteve të programuara.
- k) Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit;
- l) Miraton pasqyrat financiare që paraqiten nga organi ekzekutiv, ku jepen me hollësi burimet materiale e financiare, përdorimet e tyre dhe pasuritë e organizatës;
- m) Miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e organizatës jofitimprurëse dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm;
- n) Kontrollon rast pas rasti shpenzimet financiare të kryera nga organizata gjatë realizimit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe ato të kryera për veprimtari të përbashkëta me organizata të tjera;
- o) Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe të strukturës së organizatës;

Madhshiq *[Signature]* *[Signature]* *[Signature]* *[Signature]* *[Signature]* ⁴

- p) Krijon komitete të posaçme;
- q) Mbikëqyr veprimtarinë e organizatës jofitimprurëse, me qëllim parandalimin e përdorimit të burimeve të organizatës për qëllime terroriste, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Neni 12

Përfaqësimi i anëtarëve në Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarësisë

Anëtarët e Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë përfaqësohen personalisht në mbledhje. Në rast të pamundësisë ai mund të përfaqësohet nga një person tjetër anëtarë i shoqatës i autorizuar sipas ligjit. Një përfaqësues mund të përfaqësojë vetëm një anëtarë. Delegatët duhet të kenë dokumentin zyrtar (dokumentin e identifikimit dhe sipas rastit autorizimin e përfaqësimit). E drejta e votës në asnjë rast nuk mund t'i delegohet një anëtar tjetër.

Neni 13

Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë

Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë e zakonshme thirret nga Drejtori Ekzekutiv jo më pak se një herë në vit. Njoftimi së bashku me rendin e ditës për mbledhjen duhet t'u dërgohet anëtarëve të paktën 7 (shtatë) ditë përpara zhvillimit të mbledhjes. Për futjen ose jo në rendin e ditës të çështjeve të propozuara nga anëtarët e vendos Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë.

Neni 14

Rendi i ditës

Rendi i ditës për Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarësisë të zakonshme duhet të përfshijë çështjet e mëposhtme:

- Verifikimi i përbërjes së Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë;
- Raporti i Drejtorit Ekzekutiv;
- Miratimi i aktiviteteve të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë;
- Miratimi i raportit financiar;
- Miratimi i veprimtarive financiare për vitin pasardhës;
- Zgjedhjet për çdo vend vakant në Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarësisë;
- Diskutime nga anëtarët nga për çështje të tjera.

Neni 15

Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë e Jashtëzakonshme

- Drejtori Ekzekutiv mund të thërrasë Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarësisë të Jashtëzakonshme nëse mendohet se kjo është e domosdoshme për kushtet e shoqatës. Kur të paktën 1/3 anëtarëve të shoqatës bëjnë kërkesë me shkrim Drejtorit Ekzekutiv, ai është i detyruar të thërrasë Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarësisë të Jashtëzakonshme, jo më vonë se një muaj pas marrjes së kërkesës. Nëse Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë

Wahid *[Signature]* *[Signature]* *[Signature]* *[Signature]* *[Signature]*

nuk thirret, anëtarët që kërkuan atë, mund të thërrasin mbledhjen vetë, duke ngarkuar një kryetar të përkohshëm dhe një grup pune. Njoftimi për Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarësisë së Jashtëzakonshme duhet t'u dërgohet të gjithë anëtarëve 10 ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.

2. Drejtori Ekzekutiv vendos për rendin e ditës kur Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarësisë e thërret Drejtori Ekzekutiv. Kur ajo mbahet me kërkesën 1/3 së anëtarëve, rendi i ditës duhet të përmbajë pikat e ngritura nga këta anëtarë.

Neni 16

Vendimmarrja Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë

1. Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë mund të marrë vendime të vlefshme kur janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve (50 + 1).
2. Nëse kuorumi (50 + 1) nuk arrihet një Mbledhje tjetër e Përgjithshme e Anëtarësisë duhet të mbahet mbas 7 (shtatë) ditësh pas të parës me të njëjtin rend dite. Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë nuk duhet të marrë vendime për çështje të cilat nuk janë parashikuar në rendin e ditës, përveçse kur me votim unanim të të gjithë anëtarëve, Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë voton për ndryshimin e rendit të ditës.
3. Vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë merren me votim të hapur, me përjashtim të rastit kur 1/3 e anëtarëve të pranishëm kërkojnë votim të fshehtë. Në rast të votave të barabarta përsëritet votimi. Vendimet e marra nga Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë hyjnë në fuqi me miratimin e tyre, me përjashtim të rasteve kur Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë vendos për një datë të mëvonshme.

Neni 17

Drejtimi i Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë

1. Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë drejtohet nga Kryetari i saj, ose në mungesë të Kryetarit nga Nënkyetari ose anëtari më i vjetër i mbledhjes. Drejtuesi i mbledhjes është përgjegjës për respektimin e rendit të ditës. Ai përcakton edhe kohën në dispozicion të çdo anëtari për diskutim. Procesverbali i çdo mbledhje do të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët prezent në çdo faqe.
2. Mbledhja e parë drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv, dhe me shumicë të thjeshtë të anëtarëve zgjidhet kryetari dhe nënkryetari i Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë.

Neni 18

Zgjedhjet e organeve drejtuese

1. Zgjedhje për organet drejtuese zhvillohen me votim të fshehtë.
2. Zgjedhjet për organet drejtuese zhvillohen mbi kandidatët e propozuar nga anëtarët. Çdo anëtar ka të drejtë të propozoi një kandidat për Drejtor Ekzekutiv. Shpallet fitues kandidati që ka marrë shumicën e votave. Në rast barazimi votash zhvillohen zgjedhje vetëm midis kandidatëve që kanë vota të barabarta.

Neni 19

Ndryshimi i Statutit

W. P. S. I. P. A. J. 6

1. Statuti mund të ndryshohen vetëm me një shumicë prej $\frac{3}{4}$ të anëtarësisë. Në këtë rast aplikohen rregullat e përgjithshme të Statutit për vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë.

Neni 20

Rregullat e brendshme

1. Rregullorja e brendshme e shoqatës propozohet nga Drejtori Ekzekutiv dhe miratohet nga Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë. Rregullorja është e detyrueshme për zbatim nga të gjithë anëtarët dhe organet drejtuese.

Neni 21




Kandidati për Drejtor Ekzekutiv

1. Kandidati për Drejtor Ekzekutiv duhet të:
 - a) Të jetë me banim në Shqipëri.
 - b) Të ketë figurë të pastër morale.
 - c) Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare apo të huaja si dhe të mos jetë në ndjekje penale.

Neni 22

Drejtori Ekzekutiv dhe kompetencat e tij

1. Drejtori Ekzekutiv është organi më i lartë ekzekutiv i shoqatës.
2. Drejtor Ekzekutiv i parë është Nikolin Risilia.
3. Detyrat e Drejtorit Ekzekutiv janë:
 - a) Të përfaqësojë organizatën në marrëdhënie me subjektet, private ose publike, të tilla si donatorë, klientë furnizues apo subjekte të tjera private, si dhe me të gjitha nivelet e qeverisjes që rregullojnë veprimtarinë e organizatës; me të drejta të plota përfaqësimi;
 - b) Të sigurojë mbarëvajtjen financiare të organizatës dhe ushtrimin e veprimtarisë së saj në përputhje me qëllimin e deklaruar;
 - c) Të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për të siguruar që organizatat partnere dhe ato që sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje materiale nuk përdoren apo manipulohen për qëllime terroriste;
 - d) Të kërkojë thirrjen e Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë;
 - e) Të sigurojë zbatimin e vendimeve të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë;
 - f) Të mbikëqyrë zbatimin e aktiviteteve dhe programin e shoqatës në përputhje me qëllimin e saj;
 - g) Të vendos për pjesëmarrjen dhe aderimin e shoqatës në organizata të tjera;
 - h) Të administrojë pasurinë e shoqatës në përputhje me kërkesat e Statutit dhe është përgjegjës për to.

Wolfsküh    7

KREU V ANËTARËSIA

Neni 23 Anëtarësimi

Anëtarësimi në shoqatë është vullnetar dhe është i mundur për çdo individ, person fizik apo juridik që ka veprimtari apo synon të kontribuojë për shoqatën dhe pranon programin e Statutit të saj.

2. Pranimi i një anëtari të ri në shoqatë realizohet mbi bazën e kërkesës së tij me shkrim dhe miratimin e Mbledhjes së Përgjithshme me shumicë të thjeshtë votash.
3. Kuota vjetore për secilin anëtar është 10 000 Lekë.
4. Krite specifike për anëtarësimin në shoqatë përcaktohen nga Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë.
5. Lista e anëtarëve të shoqatës mbahet në Regjistrin e anëtarësisë dhe duhet të përditësohet për çdo pranim anëtarësie apo heqjen e tyre në përputhje me procedurat në statut dhe kjo listë konfirmohet nga Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve të saj.

Neni 24

Të drejtat dhe detyrimet e Anëtarëve të shoqatës

Anëtari i shoqatës:

- a) Njeh dhe zbaton Statutin e shoqatës;
- b) Ka të drejtë të shprehë hapur mendimet e tij në mbledhjet e organizuara dhe në rast mungese mund ti paraqesë ato e shkrim;
- c) Ka të drejtë të zgjidhet dhe të propozojë për në organet drejtuese të shoqatës;
- d) Të njihet me vendimet e organeve drejtuese;
- e) Të pajisen me botimet e shoqatës;
- f) Anëtari i shoqatës duhet të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e thirrura dhe të bëjë përpjekje për vënien në jetë të detyrave të lëna;
- g) Të përfaqësohet me të drejtë vote në Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarësisë;
- h) Të marrë pjesë në aktivitetet zyrtare, kombëtare e ndërkombëtare që organizohen nga shoqata.

Neni 25

Përfundimi i anëtarësisë në shoqatë

1. Anëtarësia në shoqatë përfundon:
 - a) Me paraqitjen e dorëheqjes me shkrim Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë për miratim.
 - b) Me përjashtimin nga anëtarësia për shkak:
 - Se janë dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që për shkak të natyrës së veprës së kryer, dëmton besueshmërinë dhe reputacionin e shoqatës;
 - Aktivitete që mund të dëmtojnë reputacionin e shoqatës.

Mausiq    8

c) Me ndarjen nga jeta e anëtarit.

KREU IV

BASHKIMI, NDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 26

Transformimi dhe bashkimi

Shoqata ka të drejtë të transformohet ose të bashkohet me vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë sipas aktit bazë dhe konsiderohet e shpërndarë me regjistrimin e subjektit të ri.

Neni 27

Likuidimi

Kur vendoset shpërndarja nga vetë shoqata, likuidimi realizohet nga një ose disa likuidatorë, të cilët caktohen nga Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë me shumicë të thjeshtë të votave.

Neni 28

Çregjistrimi

Kur shpërndarja është vendosur nga shoqata, Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarësisë, miraton raportin përfundimtar të likuidatorit me shumicë të thjeshtë të votave dhe kërkon nga gjykata çregjistrimin e organizatës jofitimprurëse.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 33


Zgjidhjet e mosmarrveshjeve

Për zgjidhjen e mosmarrveshjeve që mund të lindin midis anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarësisë bëhen përpjekjeje për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim ndërmjet tyre, në të kundërt ato shtrohen për zgjidhje me Ndërmjetësim sipas legjislacionit në fuqi dhe çdo rast tjetër Gjykatës kompetente.

Neni 34

Legjislacioni i zbatueshëm

1. Çdo klauzole e këtij statuti, apo i gjithë statuti mund të ndryshohet apo zëvendësohet pjesërisht apo tërësisht me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, me shumicën e votave të përcaktuar në këtë statut.
2. Ky statut do të interpretohet sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë. Për sa nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të zbatohen dispozitat e Ligjit "Për Organizatat Jo-fitimprurëse", Kodit Civil dhe ligjeve të tjera në fuqi.
3. Ky Statut u hartua në katër kopje origjinale në Gjuhën shqipe me vlerë të njëjtën ligjore.



4. Themeluesit autorizojnë Drejtorin Ekzekutiv z. Nikolin Risilia të paraqitet përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesën dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, për ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme për njohjen dhe regjistrimin e organizatës si person juridik.

NIKOLIN RISILIA *NIKOLIN RISILIA*

FATJONA SAKO *Fatjona Sako*

ARTUR DADO *Artur Dado*

REDMAN TOSKA *Redman Toska*

ARTAN DERSHA *Artan Dersha*



IDENTIFICATION ID



REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA



Mbiemri/Lastname

Risilla

Emri/First name

NIKOLIN

Emri i familjes/Lastname

Shqiptare/Albanian

Emri i shtetshqiptar/Albanian name

Fl./ALB

1975

Emri i ditës së lindjes/Date of birth

21-07-2020

Emri i shtetit të lindjes/Date of birth

MPB

Emri i shtetit të lindjes/Date of birth

Emri i shtetit të lindjes/Date of birth



ERNIJOFTIM ID



REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA
REPUBLICAN IDENTIFICATION CARD



mbiemri/surname

Sako

emri/given name

Fatjona

shqetesia/nationality

Shqiptare/Albanian

vendndaj/place of birth

Burrel, ALB

datelindje/date of birth

01-01-1993

data e keshtimit/date of issue

05-02-2020

autoriteti i behues/authority

MPB

nr. i caktimit/card no
035757092

shqetesia

F

data e keshtimit/date of expiry

04-02-2030

nr. personal/personal no

J35101080R

firmat/Signature

FATJONA SAKO

MPB
05-02-2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISE REPUBLIC OF ALBANIA



mbiemri/surname

Dersha

emri/given name

Artan

shtetësia/nationality

Shqiptare/Albanian

vendlindja/place of birth

Tirane, ALB

datelindja/date of birth


07-06-1963

data e feshimit/date of issue

15-03-2019

autoriteti i shprehur/authority

MPB



nr. i letërnjoftimit/card no.
034036606

emri/sex
M



data e skadimit/date of expiry

14-03-2029

nr. personal/personal no.

G306071191

firmat/signature

A. Dersha





DADO

شوق

Shoqitajir/Alboman

STATE/ALB

16-1977

16-2018


1194



033663506

06-06-2028

H70625150



REPUBLICAN ID



REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA



A1E

Signature
[Handwritten Signature]

mbiemri/murname
Toska
emri/gjurmë emri
Redman



shqetria/nacionaliteti

Shqiptare/Albanian

vendndaj/pace of birth

Fier, Fier

data e lindjes/date of birth

23-09-1973

data e rishmimit/date of issue

30-08-2013

autoriteti i shprehur/authority

MB



nr. i identifikimit/card no.
032285987

gjinia

M

data e skadencimit/date of expiry

29-08-2023

nr. personal/personal no.

M30923135P

